



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	18/19
Nr. i fq. / Br. sh	-16-
Data: / Datum	31.01.2019
VUSHTRRI-VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -XI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISE, MBAJTUR MË 27 DHJETOR 2018**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:  
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Mungoi: Sami Istrefi.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, shumicë kjo e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – pasi falënderoi drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për përgjigjen e ofruar lidhur me memorandumimin e mirëkuptimit me Bashkësinë Islame, shtoi se ai kishte kërkuar përgjigje nga kryetari i komunës. Tutje shtoi se përgjigjja e ofruar është jo e plotë, për faktin se ka indikacione se memorandumimi është i falsifikuar, në krahasim me atë që është publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe nga kjo shihet se pagesat janë bërë në kundërshtim të plotë me memorandumimin. Kjo për faktin se në bazë të memorandumit thuhet se pagesat kryhen pas faturimit dhe këtu shihet se faturim nuk ka, por pagesat janë bërë në bazë të regjistrit. Andaj lidhur me këtë ai kërkoi që të ofrohen faturat dhe nëse nuk ka fatura lidhur me shërbimet e varrimit, atëherë është mirë që të deklarohet se nuk ka fatura. Lidhur me këtë ai kërkoi të informohet me shkrim dhe t'i ofrohet memorandumimi i plotë, pagesat dhe faturat lidhur me të drejtat dhe obligimet që dalin nga memorandumimi i mirëkuptimit me Bashkësinë Islame sa i përket shërbimeve të varrimit. Gjithashtu ai kërkoi nga kryetari i komunës që t'i ofrohet memorandumimi lidhur me Kompaninë "Uniteti", për faktin se ai e di se çfarë përgjigje i ka ardhur komunës nga KRPP-ja lidhur me këtë çështje pasi që përgjigjja është se ky memorandum është në kundërshtim të plotë me ligjin.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se pasi jemi në fund të vitit fiskal 2018 fillimisht në emër të grupit kuvendar të PDK-së dëshiroj të uroj të gjithë qytetarët për transformimin e FSK-së në Ushtri të Kosovës dhe njëherit t'i shprehim dëshirat tona më të mira për konsolidimin dhe integrimin e ushtrisë sonë në organizmat ndërkombëtare. Kryetar dhe ju koalicion qeverisës, është e natyrshme të bëjmë llogaritë e performancës në fund të vitit, andaj sot do të diskutoj rreth realizimit të buxhetit 2018 nga kjo qeveri, siç i quaj unë çdoherë qeveri e humbësve të bashkuar. Të nderuar deputetë, ju të pranishëm dhe qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, ky koalicion qeverisës në raportimet financiare për periudhën janar-shtator 2018 ka pasur të realizuar buxhetin afër 27% ose shprehur në vlerën monetare 1.362.960,00€, ndërsa vetëm në tremujorin e fundit ka shpërndarë mjete kontroll e pa kontroll në vlerën prej 53% të buxhetit ose shprehur në vlerë monetare hiç më pak se 3.033.083,00€ në total shpenzimet kapitale i ka hedh nevojë e pa nevojë, pranuar shërbimin apo pa marrë shërbimin kontraktual, përfunduar punët e shërbimet apo pa përfunduar punët e shërbimet, përmbush kontratat në tërësi apo pa u përmbush obligimet kontraktuale, kjo qeveri ka shpërndarë buxhetin e qytetarëve shprehur në përqindje afro 80,04% ose në vlerën monetare ka hedh fiks 4.396.044,00€. Merrni me mend vetëm 3 ditët e fundit i ka shpërndarë më se 500.000,00€ Pavarësisht këtyre akrobacioneve të kryetarit dhe kësaj qeverie, unë dua të theksoj se ekziston dyshim i bazuar se harxhimi i parasë publike nuk është konform standardeve të aplikuara ligjore andaj unë kërkoj që mua të më dërgohen në kopje fizike raportet e pagesave me përshkrime detaje për periudhën 15.10-25.12.2018, si ditë e fundit e pagesave të lejuara. Përkundër faktit se kam dyshimet e mia mbi formën e harxhimit të parasë së qytetarëve tanë për një performancë sado kudo të kënaqshme po edhe të dyshimtë, kontributi është i dy faktorëve të cilët kanë rolin determinues në pasqyrimin e gjendjes. Krejt në fund dëshiroj të elaboroj sipas viteve performancën e tanishme: Në vitin 2015 investimet kapitale janë realizuar 84,76%, kurse granti qeveritar është realizuar 99,76% dhe totali i investimeve ka qenë 94,40%. Në vitin 2016 investimet kapitale janë realizuar 84,39%, kurse granti qeveritar është realizuar 99,89% dhe totali i investimeve ka qenë 94,71%. Në vitin 2017 investimet kapitale janë realizuar 75,18% këtu duhet të theksoj se ministria e linjës pas lansimit të kodit 5 shifrorë ka pasur indikacione negative të gjitha organizatat buxhetore dhe përkundër këtij fakti qeveria e mëparshme ka arritur që të ruaj stadin e performancës së shkëlqyer, duke arritur të realizojë grantin qeveritar 98,31%, ndërsa totali i investimeve ka qenë 91,08% dhe tani në vitin 2018 investimet kapitale janë realizuar 80,04% (4,86 më shumë se viti paraprak), kurse granti qeveritar është realizuar 93,06% (5,25% më pak se vitin paraprak), dhe totali i investimeve për herë të parë nga viti 2015 e këndeje bie nga 94,40% sa ishte në vitet paraprake në 85,80% (ose 5,28% më pak se vitin paraprak), çka tregon një performancë më të dobët të realizimit buxhetor, si rezultat të menaxhimit të dobët të kësaj qeverie komunale.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - duke bërë një rekapitullim apo siç ai e quajti bilanci i koalicionit qeverisës, shumë dështime pak suksese, vlerësoi se meqë jemi në fund të vitit 2018, nuk po dua t'i përmend premtimet elektorale e që i bie se tashmë shkoi një çerek i mandatit tuaj. Si anëtar i këtij kuvendi nëse ju kujtohet jemi zotuar se e sa herë që nëse ju (qeverisja lokale) punoni për të mirën e qytetarëve të komunës do ta keni përkrahjen e subjektit politik që ai e përfaqëson. Tutje ai përmendi sukseset të cilat e kanë karakterizuar këtë vit qeverisje: 1. rrënimi i qendrës së kulturës dhe fillimi i ndërtimit të qendrës së re; 2. përrurimi zyrtar i objektit të ri të qendrës rinore në qytetin e Vushtrrisë; 3. menaxhimi i suksesshëm i mbeturinave 4. vazhdimësia e transparencës në prokurim, ka pasur përmirësime edhe në shërbime në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe në Drejtorinë e Arsimit. Në vazhdim ai apostrofoi dështimet të cilat siç tha ai janë të shumta e që po karakterizohen me një qeverisje të dobët dhe pa koncept dhe si dështime mund të numërohen: Dështimi i furnizimit me ujë të pijes; 2. zona e lirë ekonomike në Lumadh; 3. qentë endacakë; 4. siguria nëpër shkolla;

5. ndërtimi i tregut-model i Tiranës; 6. shujtat ditore për nxënës dhe mësimdhënës. Për secilën nga këto dështime ai parashtrroi nga një pyetje për kryetarin e komunës. Për furnizimin me ujë të pijes kryetari i komunës kishte deklaruar: “Do të sigurohet uji i pijes për të gjitha vendbanimet e Vushtrrisë, brenda 12 muajve, lidhur me këtë si qëndron puna pse nuk ka ujë të pijes? Për zonën e lirë ekonomike në Lumadh kishte pasur deklarime: “*Nga buxheti i shtetit janë siguruar 1.2 milion euro për investime në periudhën 3-vjeçare (2018,2019 dhe 2020) në Zonën e Lirë Ekonomike në Lumadh*”, pyetja është a janë investuar 400,000€ të vitit 2018? Lidhur me trajtimin e qenve endacakë kryetari i komunës kishte deklaruar: “*Kjo çështje është mjaft komplekse, për këtë keni kërkuar nga Drejtoria e Emergjencës që ta rrit vigjilencën dhe keni cekur se realiteti është se me këtë çështje në të kaluarën është abuzuar dhe kontraktimi për marrjen e këtyre shërbimeve është bërë më shtrenjtë krahasuar me komunat tjera. Në fund keni thënë se për këtë duhet të ketë një strehimore*”. Keni thënë se “*komuna paguan 34€ për trajtimin e një qeni endacak, kurse zero€ për lindjen e një foshnjeje*”. Pyetja është: A keni filluar procedurat për një strehimore?, dhe çfarë keni bërë që në komunën tonë mos të harxhohen 34€ për trajtimin e një qeni endacak dhe zero € për lindjen e një foshnjeje? Për sigurinë nëpër shkolla kryetari i komunës kishte deklaruar: “*Do t’i bëjmë analizat adekuate për të bërë rritjen e numrit të policëve civilë nëpër shkolla*”. Pyetja është, a i keni bërë ato analiza dhe a është shtuar numri i policëve? Lidhur me projektin ndërtimi TREGU-Model i Tiranës, për këtë kryetari i komunës kishte deklaruar: “*Do ta ndërtojmë një treg në hyrje të Vushtrrisë, që do të jetë i modelit të tregut të Tiranës.*”, për këtë pyetja është: A e keni caktuar së paku lokacionin për këtë treg? Për shujtat për nxënësit dhe mësimdhënësit kryetari kishte deklaruar: “*Do të sigurohen shujta ditore për të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave të komunës.*” Për këtë pyetje është, a janë siguruar shujtat? Në fund pyeti Deri ku ka shkuar investimi 5 milionësh në Minierën e Dubocit nga kompania BISEK nga Polonia?

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - në përgjigjen ndaj parafolësit të tij, ceku se zona ekonomike është licencuar dhe për herë të parë është hequr ajo tokë nga duart e grabitësve dhe është sjellë në zhvillim ekonomik të komunës. Lidhur me këtë projekt është shpallur tenderi nga MTI-ja, pritet të nënshkruhet kontrata dhe projekti për realizimin e zonës ekonomike do të realizohet. Shujtat për nxënësit janë të planifikuara në buxhetin e vitit 2019. Pastaj miniera e fshatit Duboc si projekt ndodhet në fazën e vlerësimit nga Ministria e Financave sa i përket pronave dhe për këtë çështje janë mbajtur takime me banorët lokal, dhe ministria do të bëjë vlerësimin e pronave ku do të bëhet shpronësimi. Lidhur me ujin e pijshëm njoftoi se kanë gjetur zero buxhet përkundër faktit që komuna ka marrë obligim kontraktues. Komuna ka marrë përsipër që CDI-ja zvicerane të bëjë fazën e parë të investimeve, ndërkohë që komuna apo Qeveria e Kosovës të bëjë investimet në fazën e tretë dhe finale që ka të bëjë me kyçje individuale. Donatorët në këtë projekt i kanë kryer obligimet e tyre, ndërsa në buxhetin e vitit 2018 nuk ka pasur mjete të planifikuara për këtë projekt. Për vitin 2019 komuna ka kërkuar nga qeveria e Kosovës 1 milion për kyçjet individuale dhe është fat i mirë që qeveria ka ndarë rreth 600,000 € për këtë çështje me qëllim që kyçjet individuale të realizohen gjatë vitit 2019 dhe 2020, ndërsa në mbledhjen e muajit janar kur do të vendoset për rialokimin e mjeteve që kanë tepruar nga viti i kaluar do të vendosen edhe 300,000 € për këtë projekt. Sa i përket trajtimit të qenve endacakë është e vërtetë ajo që kam deklaruar më herët se komuna ka paguar më tepër për trajtimin e një qeni se sa për një fëmije të porsalindur. Lidhur me këtë problematikë ceku se këtë çështje e ka marrë në kompetencë qeveria e Kosovës dhe ia ka dërguar AVUK-ut ku qeveria e Kosovës ka ndarë 1.3 milion euro për të gjitha komunat e Kosovës për trajtimin e qenve endacakë përmes AVUK-ut. Lidhur me këtë ai njoftoi se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës e Kosovës ka kontraktuar veterinerë nga Komuna e Vushtrrisë dhe sipas informacioneve që ka në komunën tonë janë trajtuar rreth 1000 qenë endacakë. Pas një takimi që ka pasur me një organizatë

gjermane kanë ra dakord për realizimin e një qendre tranzitore për trajtimin e qenve endacakë. Lidhur me sigurinë nëpër shkolla njoftoi se kanë vendosur kamerat e sigurisë edhe në dy shkolla në qytet dhe kjo i ka kontribuar edhe sigurisë në komunitet për faktin se janë zbuluar disa raste të vjedhjeve. Për sigurinë nëpër shkolla ka biseduar me strukturat policore në Vushtri dhe ka kërkuar nga ta që të ketë policë civil nëpër shkolla, por përgjigjja është se ka numër të vogël të policëve dhe të personelit policor në Vushtri. Lidhur me zonën ekonomike në fshatin Lumadh vlerësoi se vendimi për këtë është marrë në vitin 2011, ndërsa tek në vitin 2018 është bërë licencimi i kësaj zone, kur ka ardhur në qeveri LDK-ja, ky fakt tregon se kjo pronë ka shpëtuar nga grabitësit potencial.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se qasja e kryetarit të komunës është për keqardhje, ku ai ata që e kanë përfaqësuar komunën për lidhjen e kontratave i quan grabitqar kjo është e papranueshme. Pastaj shtoi se projekti për zonën ekonomike ka filluar qysh herët, por ka pasur burokraci në realizimin e këtij projekti, ndërsa qeveria aktuale e ka gjetur në kontinuitet. Andaj lidhur me krejt këtë ai kërkoi nga kryetari i komunës që ta tërheq fjalën e tij për kualifikime si grabitës.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit** – tha se nuk është mirë që në këto forma të tentohet të gjuhët përgjegjësia se në të kaluarën ka pasur korrupsion, grabitje, dhe keqmenaxhim. Lidhur me këtë kërkoi që të vendoset televizori në sallën e kuvendit dhe kush ka fakte t'i publikojë ato ashtu që të gjithë t'i shohin ato.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - propozoi që pika lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe kërkesa për ndryshimin e vendimit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të tërhiqen nga rendi i ditës. Ai arsyetoi se në draftin e parë të draft-statutit të komunës nuk janë përfshirë të gjitha vërejtjet dhe propozimet e KPF-së dhe qytetarëve, andaj për këtë kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se janë të shqetësuar që po përdoren kësi lloj të makinacioneve për heqjen nga rendi i ditës të ndryshimeve statutit të Komunës së Vushtrrisë, edhe pse ky dokument ka kaluar në diskutimin publik. Andaj lidhur me këtë kërkoi që të jepen arsyet se përse kjo pikë duhet të hiqet nga rendi i ditës.

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** - propozoi që pika lidhur me draft-statutin dhe atë lidhur me themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, të votohen në mënyrë të ndarë e jo në pako për heqjen nga rendi i ditës.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar pikës së rendit të ditës që ka të bëjë me anulimin e konkluzionit për pronat komunale që i janë dhënë Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese, njoftoi se si LB do ta përkrahin këtë pikë, mirëpo kërkoi që ky material të kompletohet edhe me shkresa tjera ngase mungojnë kopjet e planit për disa zona kadastrale. Gjithashtu ai ceku se për një zonë kadastrale mungon certifikata e pronësisë, si dhe bëri vërejtje sa i përket mosnënshkrimit të dokumenteve nga ana e Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së** - paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin për anulimin e konkluzionit që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale ish-Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese, dhe sqaroi çështjen e nënshkrimit në Drejtorinë e Kadastrit, ku ceku se sistemi i pajisjes së qytetarëve me certifikata pronësie dhe kopje plani ka ndryshuar shumë nga vitet e kaluara, ku kopjet e planit dhe certifikatat lëshohen në mënyrë automatike dhe nënshkruhen nga një zyrtar i Drejtorisë së Kadastrit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se në sistemin e lëshimit të kopjeve të planit dhe të certifikatave të pronësisë asgjë nuk ka ndryshuar, vetëm se aty shkruan se zyrtari i drejtorisë e nënshkruan dokumentin, ndërsa drejtori e aprovon atë dhe në vend ku shkruan aprovim fare nuk ka nënshkrim.

**Para aprovimit të rendit të ditës, kuvendi me 19 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi që t’i tërheq nga rendi i ditës draft-statutin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe kërkesën për plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Pas votimit të këtyre dy pikave për heqje nga rendi i ditës, grupi kuvendar i PDK-së, në mënyrë demonstrative lëshuan mbledhjen e kuvendit, me arsyetimin se kryesuesi i kuvendit, i mohoi të drejtën anëtares së kuvendit Fjolla Ujkani për votimin e ndarë të dy pikave të sipërcekura. Pas kësaj në sallë mbeten 23 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare.

***Në fund të diskutimeve jashtë dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 1 votë “abstenim” aprovoi këtë:***

#### **REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 29.11.2018;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë;
3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratë;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktim të lokacionit për mbeturinat inerte;
5. Shqyrtimi i Raportit për implementimin e planit për integritet për vitet 2016-2018;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i ndërmarrjes regjionale “Mitrovica”;
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i ndërmarrjes “Uniteti”;
8. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim të Bahrije Pllanës;
9. Të ndryshme;
  - a). Shqyrtimi i Draft-planit të punës së kuvendit për vitin 2019;
  - b). Shqyrtimi i kërkesës nga sindikata e pavarur e fabrikës “Llamkos”;
  - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e konkluzionit të ish-Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i datës 21.4.1984 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në shfrytëzim, ish-shtëpisë ndëshkuese përmirësuese në Smrekonicë tani Shërbimi Korrektues i Kosovës;
  - ç). Shqyrtimi i raportit lidhur me konstatimin e gjendjes faktike të rrugës “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë;
  - d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shkarkimin e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike z.Emin Salihu;
  - dh). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shkarkimin e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Nevoja të Veçanta z.Edmond Krasniqi.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 29.11.2018;

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 29.11.2018.***

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë

**Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit** - tha se në shoqërinë tonë ku ende mbretëron patriarkalizmi, kemi disa dukuri negative siç është dhuna ndaj gruas, dhe forma tjera të keqtrajtimit të femrës. Ushtrimi i dhunës seksuale, është rrjedhojë e mungesës së edukimit seksual, në këto raste organet kompetente nuk shprehin gatishmëri për trajtimin e këtyre

rasteve. Organet kompetente dhe kryerësit e këtyre akteve koekzistojnë në një rreth vicioz ku aludohet se kemi degradim të institucioneve përkatëse. Si shoqëri konservatore që jemi shpeshherë për viktimat e dhunës seksuale nuk ka të ardhme të mirëfilltë sepse shoqëria i sheh më ndryshe dhe ka raste që nuk i pranojnë ato. Lidhur me këto problematika ajo propozoi që në shkollat e mesme të ulëta në lëndët zgjedhore të futet edukata seksuale si lëndë mësimore sepse nga aty fillon formësimi edukator i personalitetit të nxënësit.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se në kuadër të memorandumit që është lidhur mes komunës dhe strehimores rajonale ku kjo e fundit do të ndihmohet me një shumë financiare për më tepër se 3000 €, në këtë kuadër del se prej tri komunave janë transferuar paratë, por prej Komunës së Vushtrrisë akoma paratë nuk janë alokuar. Në këtë kontekst pyeti se në çfarë forme mund të transferohen këto mjete financiare, si dhe a ka ndonjë mundësi që para përfundimit të këtij viti ti ndahen 500 kësaj strehimoreje, për faktin se ka ngelur pa i kryer aktivitetet e saj në mungesë të mjeteve.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës**-tha se ofrimet i ndihmës financiare për OJQ-të është e sanksionuar me rregulloren e Ministrisë së Financave, dhe kjo mund të bëhet vetëm përmes ofertës publike. Në këtë relacion kërkoi nga kuvendi që të nxjerr një rekomandim më të cilin do të mundësohej shmangja nga ana e asaj rregulloreje, në të kundërtën është e pa mundur që kryetari të aprovoj mjete financiare për OJQ-të.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS** - tha se ndryshimet që kanë ndodhur në rregulloren për subvencione janë si rezultat i aprovimit të rregullores nga Ministria e Financave, andaj me këtë rregullore përcaktohet se të gjitha OJQ-të mund të financohen përmes thirrjes publike, për përfitime në vlerën mbi 500 €. Në këtë kontekst strehimorja duhet të aplikojë në ofertën publike gjatë vitit 2019.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se informata në fjalë është e hartuar shumë mirë dhe ajo i trajton gjërat në mënyrë mjaft të thuktë. Tutje duke iu referuar faqes 7 të informatës, ku flitet për personat e moshuar, bëhet e ditur se numri i personave të moshuar është duke u rritur, si dhe është evidentuar se ka persona të moshuar të cilët janë pa përkujdesje familjare. Pastaj del se nga dy raste të kësaj kategorie, njëri është vendosur në Skënderaj, kurse tjetri në Prishtinë, por ka edhe raste tjera. Në këtë kontekst shtrohet nevoja e ndërtimit të një strehimoreje në komunën tonë për këtë kategori. Kishte me qenë mirë që mjetet financiare të parashihen gjatë vitit 2019, ose të gjendet ndonjë donator për financimin e këtij projekti.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - njoftoi se Qeveria e Kosovës, i ka marrë nën mbikëqyrje, të gjitha strehimoret dhe mbështetja e tyre është planifikuar në buxhetin e vitit 2019, dhe kjo çështje tash e tutje do rregullohet nga ana e QPS-ve nëpër komunat e Kosovës.

### 3. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Administratë

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se e kupton faktin se qytetarë të komunës sonë, mund të vdesin jashtë territorit të komunës, dhe shtoi se ekziston një disproporcion i numrit të vdekjeve të regjistruara në gjendjen civile dhe regjistrin të Bashkësisë Islame që ofron shërbimet e varrimit. Kjo nënkupton që shumë vdekje nuk regjistrohen fare në regjistrin civil për të vdekurit. Ai pastaj shtroi nevojën që komuna ta detyrojë Bashkësinë Islame që mos ta lejojë varrimin pa u bërë regjistrimi në librin e të vdekurve.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit** - tha se reformat në administratë janë të dukshme dhe këtë e dëshmon fakti se qytetarët janë shumë të kënaqur me shërbimet që administrata komunale i ofron karshi qytetarëve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar faqes 5 të informatës në fjalë, ceku se ekziston një mospërputhje mes numrit të kërkesave dhe përqindjes për faktin se tek Drejtoria për Buxhet dhe Financa numri i kërkesave 552, përqindja zero, dhe kur mblidhen të gjitha këto nuk kemi përputhje.

**Mehmet Selaci drejtor i Drejtorisë për Administratë** - paraqiti sqarime sa i përket informatës në fjalë, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Tutje ai sqaroi se ka qytetar të komunës të cilët vdesin jashtë territorit të komunës sonë, dhe regjistrimi i vdekjeve bëhet në komunën përkatëse ku ka ndodhur vdekja. Pastaj shtoi se edhe përkundër faktit që nuk po mund të respektohet ligji sa i përket lajmërimit të vdekjes, e pastaj të merret leja për varrim, si Drejtori për administratë kanë kërkuar nga Bashkësia Islame që të lajmërohet komuna për çdo dy javë për numrin e vdekjeve, me qëllim që komuna t'i informojë qytetarët, përkatësisht familjet se kanë obligim që ta lajmërojnë vdekjen e anëtarit të familjes, në të kundërtën komuna do t'i shqiptojë një gjobë. Një bashkëpunim i tillë është vendosur edhe me spitalin e qytetit ku për çdo javë merret lista e fëmijëve të lindur dhe prindërit të cilët nuk i kanë regjistruar fëmijët e tyre brenda afatit ftohen që t'i regjistrojnë fëmijët, me qëllim që t'i shmangemi gjobës.

#### **4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktim të lokacionit për mbeturinat inerte**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se kjo çështje duhet të analizohet mirë për faktin se lokacioni në fshatin Gllavatin, është një lokalitet mjaft i largët nga qyteti, dhe ne jemi në dijeni se shumica e këtyre mbeturinave inerte barten nga qyteti i Vushtrrisë. Pastaj ai vlerësoi se duhet të shikohet gjendja në terren se a kemi ankesa nga ana e banorëve lokal, dhe se a shkaktohet ndonjë dëm për ata banorë. Duhet në të vërtetë të analizohet edhe çështja e transportit të këtyre mbeturinave inerte, sepse terreni nga Vushtria deri në fshatin Gllavatin është një terren mjaft i largët dhe kjo paraqet një kosto mjaft të lartë të transportit. Andaj kërkoi nga kompetentët që para se të votohet një vendim i tillë të kemi një analizë të përgjithshme lidhur me gjendjen në terren.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se në territorin mes fshatit Stroc dhe Gllavatin, ekziston një gropë, dhe për mbylljen e saj kemi pasur kërkesë nga banorët e atjeshëm, pasi që ajo gropë paraqet rrezik për nxënësit e shkollës së fshatit Stroc. Pastaj ai arsyetoi se më herët ka qenë një vendim që deponia për mbeturina inerte ka qenë në fshatin Pestovë, por tanimë kjo është mbyllur. Caktimi i dy lokacioneve, njëri në fshatin Gllavatin dhe tjetri në fshatin Gojbulë, është bërë me qëllim që të kemi një shtrirje për krejt komunën sa i përket dërgimit të këtyre mbeturinave. Gjithashtu propozoi që më këtë vendim të shfuqizohet marrëveshja për deponinë për hedhjen e mbeturinave inerte në fshatin Pestovë.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim caktohen lokacionet për grumbullim të mbeturinave inerte në fshatin Gllavatin, pjesa nga parcela kadastrale P-70202017-00566-0 zona kadastrale Gllavatin, e cila evidentohet si pronë shoqërore e Komunës së Vushtrrisë me numër të parcelës 566-0, si dhe në fshatin Gojbulë pjesa nga parcela kadastrale P-70202018-00131-0 zona kadastrale Gojbulë, e cila evidentohet si pronë shoqërore-ekonomia e pyjeve.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtorja për Shërbime Publike, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorja e Inspektiveve.**

**3 .Me këtë vendim shfuqizohet marrëveshja e mirëkuptimit e lidhur mes kryetarit të komunës dhe Fadil Maxhunit me numër të protokollit 02.Nr-361/15 e datës 18.3.2015.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**5. Shqyrtimi i Raportit për implementimin e planit për integritet për vitet 2016-2018**

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - tha se dua t'i përgëzoj të gjitha drejtoritë komunale, për punën e mirë që kanë bërë në implementimin e këtij plani. Pastaj njoftoi se çdo dokument i cili ka të bëjë me prokurimin publik është publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe për këtë komuna ka marrë vlerësimin nga USAID-i amerikan si komuna më transparente në Republikën e Kosovës për sa i përket zbatimit të ligjshmërisë në prokurimin publik.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se vlerësimi i USAID-it, bënë pjesë edhe në vitin 2017, dhe kjo duhet të evidentohet nga kryetari i komunës e jo t'i marrë të gjitha merita për vete.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprohet Raportit për Implementimin e Planit të Integritetit për vitet 2016-2018 i Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi, është aprovimi raportit lidhur me planin e integritet, i cili ka për objektivë forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e parasë publike.**

**3. Pjesë përbërëse e këtij vendim është dokumenti me emërtimin Raporti për Implementimin e Planit të Integritetit për 2016-2018.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**6. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i ndërmarrjes regjionale “Mitrovica”**

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - pyeti përfaqësuesin e Kompanisë së Ujësjiellit “Mitrovica” se si ka mundësi që bordi i drejtorëve ekzekutiv dhe Komisioni i Auditimit të jenë të njëjtë persona.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** - tha se ky raport është mjaft voluminoz, dhe i njëjti është dashur të jetë më i shkurtër dhe të paraqet gjendje reale e cila është në këtë ndërmarrje. Tutje pyeti se përse ky raport nuk ka ardhur në tremujorin e parë të vitit 2018, pasi tani gjendemi në fund të dhjetorit të këtij viti, dhe është e pakuptimtë që është tejkaluar çdo limit kohor i raportimit për vitin 2017. Ajo çka karakterizohet në këtë raport është rënia e performancës dhe inkasimit të të hyrave dhe për këtë pyeti cilat janë masat që i ka ndërmarrë bordi ekzekutiv drejtues i kompanisë në fjalë. Gjithashtu kërkoi të informohet për profesionin e anëtarëve të bordit drejtues.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar faqes 31, pika 15, raporti lidhur me investimet kapitale, për këtë paraqiti vërejtjet e tij ku ceket se CDI, ka investuar në ndërtimin e rrjetit të përbashkët për furnizim me ujë të pijshëm për 25 fshatra. Më poshtë thuhet se punimet në shtrirjen primare të gypave dhe lidhjet e nyjave të valvulave teleskopike, kanë



përfunduar në fshatrat e rajonit të Çiçavicës, por e vërteta është se në disa fshatra fare nuk është shtrirë rrjeti i ujësjellësit siç është fshati Stroc dhe Beçuk, por edhe në disa fshatra tjera ku është shtrirë rrjeti ka vërejtje. Lidhur me këtë ai kërkoi përgjigje nga përfaqësuesi i kompanisë se a është bërë pranimi teknik i këtij projekti dhe nëse është bërë pranimi, atëherë si kompani a kanë vërejtje.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** - pyeti se sa është numri i punëtorëve, në njësinë e ujësjellësit në Vushtrri, si dhe sa është numri i konsumatorëve komercial, pasi kemi një shpërputhje mes numri të bizneseve në Komunën e Vushtrrisë, dhe numrit të konsumatorëve komercial. Tutje vlerësoi se si është e mundur të funksionojë një kompani me 70% humbje në inkasim dhe faturim dhe pyeti se cilët janë hapat që i ka ndërmarrë kompania për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Sipas një raporti që komuna e posedon, numri i konsumatorëve komercial nuk e kalon numrin 100. Pastaj kompania “Mitrovica” i faturon borxhe qytetarëve sa i përket mirëmbajtjes së kanalizimit, ndërkohë që nuk ofron shërbime për këtë çështje. Sa i përket inkasimit të borxheve, për këtë duhet të përdoren mekanizmat ligjor siç është përmbauesi privat dhe gjykatat kompetente.

**Vehbi Fejza, përfaqësues i Kompanisë Ujësjellësi Mitrovica** - paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë duke, u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se e vërteta është që kjo kompani është në autoritetin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe ajo nuk i jep përgjegjësi nivelit lokal. Por megjithëkëtë ne nuk mund të pajtohemi me një raport të tillë, kur kemi kaq shumë humbje qoftë teknike, qoftë komerciale dhe kjo kompani ka sjell një raport në kuvend sa për të thënë se ka raportuar dhe si të tillë nuk mund ta votojë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se përfaqësuesin e kompanisë në fjalë, është dashur që ta shoqërojë edhe përgjegjësi i njësisë së ujësjellësit në Vushtrri, i cili do të raportonte për gjendjen në terren të kësaj kompanie. Përgjegjësi i njësisë sigurisht se e njeh situatën më mirë dhe kjo do ta lehtësojë punën e raportimit. Lidhur me humbjet financiare dhe teknike duhet të merren masa nga menxhmenti i kompanisë, në të kundërtën gjendja veç sa do të keqësohet.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se kuvendi duhet të këtë një qëndrim të artikuluar mirë, që të inicojë ndarjen e njësisë së kësaj kompanie nga regjioni dhe kjo do ta përmirësonte gjendjen në këtë kompani.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi rekomandon që Drejtoria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me Njësinë e Auditimit dhe Zyrën e Kryetarit, të hartojë rekomandime lidhur me përmirësimin e gjendjes në Kompaninë Ujësjellësi “Mitrovica”. Obligohen të lartpërmendurit që ta analizojnë raportin e kësaj kompanie dhe konform raportit t’i hartojnë rekomandimet ku të njëjtat do t’i adresojnë kompanisë në fjalë dhe për këtë do ta informojnë kuvendin e komunës në mbledhjen e kuvendit të datës 31.1.2019.**

## 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor 2017 i ndërmarrjes “Uniteti”

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - vlerësoi se gjendja e pastrimit të mbeturinave kohëve të fundit është përmirësuar dukshëm, kjo shihet si nga aspekti teknik i kompanisë ashtu edhe në pajisjen me kontejnerë të ekonomive familjare, por edhe eliminimin e deponive të mbeturinave. Tutje shtoi se punëtorët e kompanisë “Uniteti” janë duke punuar në kushte të vështira, dhe atyre iu mungon edhe një lokacion për ndërtimin e një objekti administrativ, por edhe një zveshtore.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se derisa e lexon raportin e auditorit për pasqyrat financiare të kompanisë “Uniteti”, tenton të nxjerr diçka pozitive, por kjo është shumë e vështirë. Tutje vlerësoi se gjithçka që është punuar në këtë kompani, aktiviteti nuk i është

nënshtuar ligjit. Pas ndryshimit të strukturave menaxhuese shpreson që të ketë ndryshime pozitive në të ardhmen.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - tha se edhe përkundër kushteve të vështira të punës, punëtorët e kompanisë “Uniteti” janë duke bërë një punë të jashtëzakonshme në pastrimin e deponive ilegale, por edhe në mbulimin me kontejnerë të territorit të komunës. Pastaj përsëriti se është e domosdoshme që të bëhet ndarja e kompanisë “Uniteti” nga regjioni, kjo me të vetmin qëllim që kjo kompani të jetë sa më funksionale.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** - tha se duhet të merren për bazë rekomandimet e auditorit, ku janë identifikuar problemet dhe të hartohet një plan për adresimin dhe fillimin e zgjedhjes së këtyre problemeve.

**Agim Krasniqi, përfaqësues i kompanisë “Uniteti”**- paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me vota unanime, aprovoi Raportin vjetor 2017 të ndërmarrjes “Uniteti”, me rekomandimin që nëse ka materiale që duhet të hetohen, ato të procedohen në organet kompetente, si dhe të hartohet një plan i veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm.**

#### **8. Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për shërim të Bahrije Pllanës**

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS** - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë kërkesë, duke shtuar se tani jemi në fundvit dhe mjetet buxhetore janë shpenzuar, si dhe procedurat për alokimin e mjeteve financiare janë përmbyllur. Tutje ai duke iu referuar rregullores për subvencionet, ceku se ajo çka kuvendi aktualisht mund të bëjë është që mund t’i rekomandojë komisionit shëndetësor në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë që ky i fundit t’i rekomandojë kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare për shërim konfrom rregullores për subvencione e që vlera maksimale është deri në 1,000€.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – vlerësoi se duhet të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për shërimin e znj. Bahrije Pllana, dhe atë përmes vendimit të kryetarit të komunës, Drejtorisë për Shëndetësi, si dhe përmes Drejtorisë së Arsimit, ashtu që të arrihet vlera e ndihmës financiare deri në 3.000 €.

**Ymer Haradinaj anëtar i kuvendit** – tha se është mirë të shfrytëzohen të gjitha mundësitë ligjore që profesoreshës Bahrije t’i ofrohet ndihma e nevojshme pasi që ajo vuan nga një sëmundje serioze e cila është mjaft e kushtueshme. Pastaj vlerësoi se ajo ka dhënë një kontribut të çmuar para luftës, gjatë luftës, si dhe pas luftës, si në jetën politike ashtu dhe në fushën e arsimit. Andaj në emër të grupit kuvendar të VV-së kërkoi që të shfrytëzohen të gjitha format ligjore që t’i dilet në ndihmë të lartcekurës, që vlera e ndihmës të jetë minimalisht 3000 €.

**Hysni Gërguri anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, vlerësoi se znj. Pllana ka dhënë një kontribut të shquar dhe apeloj që të gjinden forma të ndryshme që t’i dilet në ndihmë pasi që e njëjta vuan nga një sëmundje e rëndë dhe cila sëmundje është shumë e kushtueshme, andaj përsëriti që të shfrytëzohet fondi i zyrës së kryetarit, i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe asaj të arsimit që të paktën t’i ndahet një shumë e mjeteve financiare deri në 3,000 €.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS** - njoftoi se rregullorja e subvencioneve, nuk i len mundësi kuvendit që të ndajë mjete financiare, por kuvendi mund t’i rekomandojë kryetarit të komunës. Pastaj shtoi se nëse kuvendi e sheh të rrugës, rregulloren mund ta ndryshojë, ashtu që t’i jap kompetencë kuvendit që të ndajë mjete financiare deri në një limit të caktuar, por gjithsesi që duhet të ketë një limit pasi rregulloja e vjetër, nuk ka pasur një përkufizim për

vlerën financiare dhe në të kaluarën kemi pasur ndarje të mjeteve në mënyrë joparimore. Në këtë kontekst vlerësoi se heqja e të drejtës kuvendit për të ndarë mjete financiare, si dhe kufizimi i vlerës është bërë me qëllim që të vendoset një drejtësi sociale, sepse nuk është e drejtë që dikujt t'i ndahen 5000 € dhe dikujt tjetër 300 € për rastet e sëmundjeve të rënda.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - propozoi që t'i ndahen 1000 €, kurse në fillim të vitit 2019 të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme dhe rastit në fjalë t'i ofrohet ndihmë edhe me 1,000 € tjera. Ndërsa rastet tjera të rënda të personave në moshë të re që vuajnë nga sëmundje të rënda ato raste i mbulon Ministria e Shëndetësisë.

**Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS** - sqaroi se rregullorja për subvencionet është e qartë, e cila përkufizon që për shumën e mjeteve financiare, deri në 300 € vendos komisioni në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë, kurse mbi shumë 300 € deri në 1000 € komisioni i rekomandon kryetarit të komunës i cili me vendim i ndanë këto mjete.

**Abdulla Vojvoda, anëtar i kuvendit** - tha se znj. Pllana, ka dhënë një kontribut të çmuar, andaj e njëjta duhet të ndihmohet dhe për këtë duhet të gjenden mundësitë ligjore për ofrimin e kësaj ndihme.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 dhjetor 2018, pas shqyrtimit të kërkesës së znj. Bahrije Pllana, për ofrimin e ndihmës financiare për shërim, Kryetarit të komunës dhe drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i parashtron këtë:

#### **REKOMANDIM**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Kryetarit të komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë, që të sipërcekurës t'i ndajë mjete financiare në vlerë prej një mijë euro (1000 €), dhe më pas në muajin e ardhshëm të shikohet mundësia që të njëjtës t'i ofrohet sërish ndihmë financiare, pasi që ajo vuan nga një sëmundje e rëndë, dhe kostoja e shërimit të saj është shumë e lartë.

Rekomandohet që zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, t'i zhvillojnë procedurat e akordimit të kësaj ndihme financiare konform legjislacionit në fuqi.

**10. Shqyrtimi i Draft-planit të punës së kuvendit për vitin 2019**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - propozoi që në muajin mars të futet si pikë themelimi i Komitetit Konsultativ për kategoritë e dal nga lufta e UÇK-së, ku të drejtën e inicimit të këtij komiteti duhet ta bart kryesuesi i kuvendit, dhe përbërja e tij do të jetë katër anëtarë nga radhët e kuvendit, kurse 3 anëtarë nga radhët e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019.***

**11. Shqyrtimi i kërkesës nga sindikata e pavarur e punëtorëve të fabrikës “Llamkos”**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se kjo ndërmarrje është në procedurë gjyqësore të falimentimit dhe kuvendi nuk ka në kompetencë që të ndikojë në këtë proces, por megjithatë

kuvendi mund të nxjerrë një rekomandim për përkrahjen e punëtorëve dhe mbrojtjen e interesit për mosndërrimin e destinimit të kësaj fabrike.

**Miran Halili, drejtor i DBEZHR** - tha se kjo shkresë është vetëm sa për t'ia përkujtuar kryetarit të komunës, se kur bëhet fjalë për likuidimin e kësaj ndërmarrjeje të kemi për bazë interesin që të ruhen asetet e fabrikës dhe mosndryshimi i destinimit të fabrikës.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 dhjetor 2018, pas shqyrtimit të kërkesës të Sindikatës së pavarur të punëtorëve të fabrikës “Llamkos”, dhe pas analizimit të gjendjes së kësaj fabrike, të lartapostofuarve iu parashtron këtë:

### **REKOMANDIM**

**1.** Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon kryetarit të komunës, që të mbrojë unitetin e qytetarit në mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të punëtorëve të fabrikës “Llamkos”.

**2.** Kryetarit të komunës i rekomandohet që të mbrojë qëndrimin unanim të përfaqësuesve të qytetarëve në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, që fabrikës “Llamkos” të mos i ndërrohet destinimi i pronës gjatë procedurës së falimentimit të kësaj ndërmarrjeje.

**3.** Gjithashtu kuvendi rekomandon që administratori falimentues të ketë për bazë dhe të marrë në konsideratë interesin e punëtorëve, të mbrojë qëndrimin, në mënyrë që të ruhen asetet e fabrikës “Llamkos” nga ndërrimi i destinimit, si dhe mbrojtja e pronës e kësaj ndërmarrjeje.

**12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për anulimin e konkluzionit të ish-Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë i datës 21.4.1984 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në shfrytëzim ish-Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese në Smrekonicë tani Shërbimi Korrektues i Kosovës.**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga kryetari i komunës që të gjendet një modus mes Qeverisë së Kosovës dhe komunës, që pronave që qeveria i ka në shfrytëzim t'i jepet pronësia, dhe qeveria të mundësojë që ato prona që janë në emër apo në shfrytëzim të qeverisë apo agjencioneve tjera të nivelit qendror të kthehen në pronësi të Komunës së Vushtrrisë për nevojat tona. Pastaj kërkoi që lënda lidhur me këto prona të kompletohet me certifikata të pronësisë dhe kopje të planit dhe që këto dokumente kadastrale të jenë të aprovuara nga ana e drejtorit ashtu siç e kërkon ligji. Lidhur me vendimin e kuvendit për shpalljen e zonës së interesit në këto prona, njoftoi se vendimi i kuvendit për shpallje zonë interesi është për disa parcela kadastrale, dhe jo në tërësi për të gjitha parcelat e evidentuara në këtë propozim-vendim. Në fund vlerësoi që ky propozim-vendim nuk është studiuar si duhet dhe ka drojën se MAPL do ta kthejë këtë vendim si joligjor.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se, si organ kompetent i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, për kthimin e këtyre pronave në pronësi komunale për nevojat e komunës. Tutje njoftoi se kryetari ka zhvilluar takim me kryeministrin, por takime ka pasur edhe me zyrtarët e

Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me këtë çështje, por ata nuk kanë qenë të sigurt për dhënien e pëlqimit për kthimin e pronësisë komunës lidhur me këto prona.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

**1.Me këtë vendim anulohet Konkluzioni i Kuvendit të Komunës 12 Nr.465-81, i datës 21.4.1984, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale ish-Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese në Smrekonicë, (tani Shërbimi Korrektues i Kosovës).**

**2. Komunës së Vushtrrisë i kthehen në pronësi dhe shfrytëzim parcelat kadastrale si në vijim:**

**2.1 Parcelat kadastrale nr.447 me sipërfaqe prej 63716 m<sup>2</sup>, P-449 me sipërfaqe prej 21115 m<sup>2</sup>, P-1041 me sipërfaqe prej 9109 m<sup>2</sup>, P-1042 me sipërfaqe prej 837m<sup>2</sup>, P-1047 me sipërfaqe prej 61376 m<sup>2</sup>, P-1077-3 me sipërfaqe prej 210 m<sup>2</sup>, P- 1078 me sipërfaqe prej 25304 m<sup>2</sup>, P-1080 me sipërfaqe prej 42484 m<sup>2</sup>, P-1084 me sipërfaqe prej 1202 m<sup>2</sup>, P-1105 me sipërfaqe prej 3527 m<sup>2</sup>, P-1075 me sipërfaqe prej 1673 m<sup>2</sup>, P-1076 me sipërfaqe prej 2204 m<sup>2</sup>, ZK Sumë (Pasomë).**

**2.2 Parcelat kadastrale P-69-1 me sipërfaqe prej 559975 m<sup>2</sup>, P-69-5 me sipërfaqe prej 280 m<sup>2</sup>, P-70-1 me sipërfaqe prej 16021 m<sup>2</sup>, P-70-3 me sipërfaqe prej 13698 m<sup>2</sup>, P-75 me sipërfaqe prej 3290 m<sup>2</sup>, P-76 me sipërfaqe prej 1880 m<sup>2</sup>, P-79-2 me sipërfaqe prej 69749 m<sup>2</sup>, P-80 me sipërfaqe prej 4840 m<sup>2</sup>, P-69-6 me sipërfaqe prej 15144 m<sup>2</sup>, P-72 me sipërfaqe prej 18898 m<sup>2</sup>, P-74 me sipërfaqe prej 53640 m<sup>2</sup>, P-77 me sipërfaqe prej 6210 m<sup>2</sup>, P-78 me sipërfaqe prej 5040 m<sup>2</sup>, ZK Banjë.**

**2.3 Parcelat kadastrale P-2 me sipërfaqe prej 3594 m<sup>2</sup>, P-10 me sipërfaqe prej 5360m<sup>2</sup>, P-13 me sipërfaqe prej 2194 m<sup>2</sup>, P-15 me sipërfaqe prej 295843 m<sup>2</sup>, P-18 me sipërfaqe prej 7596 m<sup>2</sup>, P-20 me sipërfaqe prej 2720 m<sup>2</sup>, P- 21 me sipërfaqe prej 53262 m<sup>2</sup>, P-23 me sipërfaqe prej 72455 m<sup>2</sup>, P-94 me sipërfaqe prej 14497 m<sup>2</sup>, P-97 me sipërfaqe prej 10212 m<sup>2</sup>, P-99 me sipërfaqe prej 37003 m<sup>2</sup>, P-100 me sipërfaqe prej 37511 m<sup>2</sup>, P-1 me sipërfaqe prej 370773 m<sup>2</sup>, P-7 me sipërfaqe prej 108123 m<sup>2</sup>, P-9 me sipërfaqe prej 340950 m<sup>2</sup>, P-11 me sipërfaqe prej 17313 m<sup>2</sup>, P-14 me sipërfaqe prej 13590 m<sup>2</sup>, P-22 me sipërfaqe prej 5544 m<sup>2</sup>, ZK Qytezë (Smrekonicë).**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e cila duhet të bëjë regjistrimin e pronave të cekura në nenin 1 të këtij vendimi në emër të Komunës së Vushtrrisë.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**13. Shqyrtimi i raportit lidhur me konstatimin e gjendjes faktike të rrugës “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se nga shikimi në vendngjarje, komisioni ka vërejtur se në terren është devijuar staza e trotuarit, por megjithatë arsyetimet e ekspertëve e kanë bindur komisionin, për faktin se në anën e epërme të rrugës ekziston një kanal kullues dhe në pjesë të caktuara mungon prona e cila është në pronësi komunale dhe për këtë arsye kemi pasur devijim të anës së trotuarit dhe në këtë kontekst gabimi është sa i përket hartimit të paramasës dhe parallogarisë, sepse nuk ka pasur logjikë që trotuari të vendoset në anën e epërme të rrugës. Për këtë ai vuri në theks se në të ardhmen nuk duhet që këto projekte të hartohen nga zyra, por duke u shikuar gjendja në terren. Sa i përket gjerësisë së trotuarit në paramasë, gjerësia është 1.20 cm, por ka vende që gjerësia është prej 4 deri në 6 metra, dhe këtu ka qenë arsyetimi i menaxherit të kontratës që zgjerimi i trotuarit të bëhet në afërsi të shkollës për vendosjen e mjeteve motorike. Në pjesën e poshtme të rrugës, një shtëpie i është bërë e pamundur kyçja apo hyrja në oborrin e shtëpisë. Në fund tha është shumë e nevojshme që të vendosen pengesa në rrugë (policë të shtrirë), për faktin se ekziston rreziku për këmbësorët nga lëvizja e shpejtë e automjeteve.

**Ymer Haradinaj anëtar i kuvendit** – njoftoi se njëri nga anëtarët e komisionit Agron Përçuku nuk ka qenë në vendngjarje, dhe herëve tjera është mirë që kur marrim përgjegjësi të kryejmë ato. Ajo që duhet theksuar është deklarimi i përfaqësuesit të lagjes parashtrues i petitionit z. Afrim Morina, nga i cili është vërejtur një tendencë për t’i fajësuar disa persona përgjegjës. Por pavarësisht këtyre është mirë që atje është përfunduar një projekt mjaft i rëndësishëm për qytetarët. Mandej përfaqësuesi i lagjes gjatë deklarimit në kuvend kishte shprehur dyshimin e tij se kubëzat e trotuarit në shumësi janë të dëmtuara, por nga shikimi në vendngjarje del se një konstatim i tillë nuk qëndron pasi që puna është kryer me profesionalizëm nga kompania punëkryerëse. Sa i përket urës, vlerësoi se aty ka nevojë të bëhet një urë e re, ndërsa devijimi i trotuarit është bërë me arsye për shkak se pjesa ku është insistuar që të bëhet trotuari nga parashtruesi i petitionit, do të shkaktonte një kosto më të lartë financiare, ku do të kishte nevojë për shpronësim të pronave, pastaj kanali kullues, dukshmëria, e të gjithë këta faktorë kanë bërë që të jepet ky rekomandim i cekur në raport. Lidhur me vendosjen e shenjëzimit horizontal dhe vertikal është me rëndësi që kjo të bëhet në secilën shkollë filllore dhe të mesme me qëllim të rritjes së sigurisë së nxënësve.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – arsyetoi se pavarësisht asaj se atë ditë nuk ka mundur të jetë në vendngjarje, ai ka dalë më vonë atje dhe ka shikuar vendin e ngjarjes, si dhe ka kontaktuar me banorët lokal të fshatit Akrashticë, andaj konform vlerësimeve që ka bërë ai e ka nënshkruar raportin.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** - tha se komisioni kuvendar është dashur që të merret edhe me konstatimin e rrugës e cila ndodhet më afër shkollës ku kalojnë nxënësit, për faktin se atje nuk ka një rrugë e cila është e përhershme, por është vetëm një rrugë për punimin e arave, dhe aty bëhet fjalë për pronë private, ku në të ardhmen ata persona mund t’i ndalojnë këmbësorët që të kalojnë në atë rrugë. Komisioni është dashur që ta definojë këtë problematikë, sepse nëse mbyllet kjo rrugë atëherë, nxënësit duhet të kalojnë nëpër një rrugë tjetër alternative qarkore e cila është larg për vijimin e nxënësve në shkollë. Në fund tha se në rrugën “Vullnetari i UÇK-së” nuk ka nevojë që të ndërtohet një urë e re, por vetëm duhet të riparohet ura aktuale.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se ndërtimi i urës së re është e shumë e nevojshme kjo për faktin se edhe rreziqet që shkaktohen në atë rrugë vijnë si rezultat i konfiguracionit të asaj ure, andaj para se ajo të riparohet do të ishte më mirë të bëhej një urë e re.

**Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit** - tha se për shkak të buxhetit të limituar, të komunës, do të ishte më me vend që ndërtimi i urës të shtyhet për një periudhë të caktuar, por është shumë

immediate vendosja e shenjzimit horizontal dhe vertikal, për faktin se automjetet aty kalojnë me një shpejtësi shumë të madhe dhe rrjedhimisht aty rrezikohen këmbësorët dhe posaçërisht nxënësit.

**Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me raportin në fjalë, duke shtuar se zgjerimi i trotuarit afër shkollës nuk është bërë për ndaljen e automjeteve të personelit të shkollës, por është bërë me qëllim që masa e madhe e nxënësve që dalin nga shkolla kur kryhet ndërrimi përnjëherë, kanë nevojë që të kenë një hapësirë derisa të kyçen në rrugën drejt shtëpive të tyre.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 dhjetor 2018, duke marrë për bazë peticionin e banorëve të fshatit Akrashticë, lidhur me konstatimin e gjendjes faktike në rrugën “Vullnetari i UÇK-së”, si dhe duke u mbështetur në raportin e komisionit kuvendar lidhur me konstatimin e gjendjes faktike në rrugën “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë, Drejtorisë për Shërbime Publike i parashtroi këtë:

### **REKOMANDIM**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i mbështet rekomandimet e komisionit kuvendar lidhur me konstatimin e gjendjes faktike në rrugën “Vullnetari i UÇK-së” në fshatin Akrashticë, si në vijim:

- **Të bëhet zgjerimi i urës ose të ndërtohet urë e re, duke ndërtuar shtegun për këmbësorë përgjatë urës me ndarje fizike, minimum 1.5 m gjerësi;**
- **Të vendosen pengesa (policë të shtrirë) profesionale në hyrje dhe dalje të urës dhe në afërsi të shkollës.**
- **Të bëhet shenjzimi horizontal dhe vertikal në mënyrë që pjesëmarrësit në komunikacion të njoftohen me kujdesin në vozitje dhe shpejtësinë e lejuar të vozitjes.**
- 

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, e vlerëson pjesërisht të arsyeshëm peticionin e banorëve të fshatit Akrashticë, lidhur me gjendjen e krijuar në rrugën “Vullnetari i UÇK-së” dhe kërkon nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që t’i zbatojë rekomandimet e komisionit kuvendar.

*Gjithashtu kuvendi kërkon nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që banorët e këtij fshati parashtrues të peticionit, të njoftohen me shkrim për shqyrtimin e peticionit nga ana e Kuvendit të komunës, si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e drejtorisë lidhur me çështjen në fjalë.*

**14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shkarkimin e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike z.Emin Salihu.**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim, z. Emin Salihu shkarkohet nga detyra e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike, i cili duke mos arsyetuar mungesën e tij, ka munguar në disa mbledhje radhazi në komitetin e lartcekur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e personelit dhe Sekretaria e kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shkarkimin e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Nevoja të Veçanta z.Edmond Krasniqi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:


1.Me këtë vendim, z. Edmond Krasniqi shkarkohet nga detyra e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta, i cili duke mos arsyetuar mungesën e tij, ka munguar në disa mbledhje radhazi në komitetin e lartcekur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryesuesi i kuvendit, Njësia e personelit dhe Sekretaria e kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Mbledhja përfundoi në ora 15:00.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

